

## Konfliktet

# 7

### Strategjitë e tejkalimit të konflikteve gjatë shkollimit



Çdokund, ku njerëzit takohen, në çdo kohë mund të vjen deri tek konflikti. Në masë të madhe kjo vlen edhe për arsimimin dhe shkollimin profesional. Shpesh kemi të bëjmë me botëkuptime, mendime dhe qëndrime të ndryshme që bien ndesh njëra me tjetrën, ose kemi interesa personale që janë shumë larg njëra tjetrës.

Një konflikt është gjithnjë grindje, ku njeriu, duhet të vendos së paku në mes të dy qëndrimeve.

Secili njeri reagon ndryshe në situatë konflikti. Përjetimi i një zhgënjimi në pah apo konkret si dhe frustrimi janë tipike për shumicën e konflikteve, por derisa disa reagojnë në mënyrë agresive apo depresive, të tjerët reflektojnë apo kërkojnë një dalje nga kjo gjendje.

Njeriu mund të ketë konflikt me vehten e tij apo me ndonjë njeri tjetër. Mësimdhënësi mund të ketë konflikt me një nxënës apo me tërë grupin. Gjithashtu janë të mundshme konfliktet mes grupeve.

*Parimisht vlen, se konfliktet zbulojnë problemet, që shpiejnë te njohja e vetëvehtes dhe pengojnë ngecjet. Për këtë arsye konfliktet kanë një anë pozitive gjë që shpesh lihet pas dore.*

#### **Ndikimet pozitive të konflikteve**

- Nxitja (përkrahja) e vetëbesimit
- Nxitja (përkrahja) e mënyrave vepruese personale
- Nxitja (përkrahja) e personalitetit
- Instrumenti drejtues për procesin mësimor
- Forcimi i mbështjetjes grupore

Secili mësimdhënësi duhet të mirret koncretisht me konfliktet e krijuara dhe të zbulojë shkaqet e tyre. Për një gjë të tillë, parakusht i rëndësishëm është njohja e strukturës së grupit si dhe paraqitja e ndryshme e roleve të disa anëtarëve të grupit.

*(Krahaso, ushtrimet lidhur me paraqitje e roleve në grupe në shtesën A)*

Mësimdhënësi ka një përgjegjësi të madhe për të penguar zgjerimin e konfliktit. Ai duhet t'i qetësoj shpirtërat dhe tu jep mundësinë të gjithë pjesëmarrësve të paraqesin pikëpamjet e tyre, kështu që të ndërtohet klima e besimit.

Në shkollimin profesional, kryesisht dallojmë këto lloje të konflikteve:

### Llojet e konflikteve

LLOJET E KONFLIKTEVE		
KONFLIKTET-VENDIMMARRËSE	KONFLIKTET E ROLEVE	KONFLIKTET E GJENERATAVE
Alternativa të shumta për zgjidhjen e një problemi, bien në kundërshtim	Personifikimi i roleve të ndryshme, mund të shkaktojë konflikte në mes të nxënësve	Konflikte në mes të nxënësve dhe prindërve, konflikte në mes të ësimdhënësit dhe nxënësit

Konfliktet asnjëherë nuk duhet „fshirë nën tepih“ apo ti trajtojmë joseriozisht. Një sqarim sa më i hershëm i tyre, është shumë me rëndësi për një punë të sukseshme në mes të mësimdhënësit dhe nxënësit.

Gjatë punës së tij, çdo mësimdhënës duhet pasur parasysh këto këshilla:

### Këshilla për të mënjeluar konfliktet

- Ndëgjim aktiv
- Gjithnjë të shikohet „prapa perdeve“ në mënyrë që mos të kemi acarim të panevojshëm të konfliktit
- Mos tu ikim konflikteve dhe problemeve, por t'u qasemi haptas
- Mos ti potencojmë konfliktet e vogla, që zgjidhen vetvetiu

Shkaqet kryesore të konflikteve në grupe pune mund të shihen në fushat që vijojnë:

### Shkaqet kryesore të konflikteve

- Mirënjohje dhe sukses i pakët në shkollim
- Nivel i ndryshëm arsimor dhe i njohurive
- Mangësi në të përshtaturit social dhe në aftësitë integruese (pozitë jashtë loje)
- Aftësitë duruese dhe konstruktive të ndryshme
- Kohë e shkurtër për zgjidhjen e disa detyrave shkollore (faktor i stresit)

## Strategjitë e tejkalimit të konflikteve gjatë shkollimit

# 7

Për zgjidhjen e konflikteve të lartpërmendura ka mundësi të ndryshme:

### Strategjitë e tejkalimit të konflikteve gjatë shkollimit

#### KONSENSI

Kjo për pjesëmarrësit nënkupton: Se asnjëri nuk është humbës.  
Zgjidhje që vlen të provohet!

#### ZGJIDHJA ME KOMPROMIS

Secili tërhiqet pak nga kritikata e mundshme.  
Formë zgjedhëse e shpeshtë!

#### MENDIMI I SHUMICËS

Mendimi që pranohet, ka pëlqimin e shumicës.

#### DAKORDIMI

Rënia dakord lidhur me një qëndrim, si rezultat i ndonjë bisede.

#### KYÇJA E JO PJESËMARRËSVE

Personi pedagogjik kompetent, propozon zgjidhjen.



Nuk mund të ketë një zgjidhje të përgjithshme për konfliktet e lartpërmendura, por ka hapa të ndërlidhura, me parashtrimin e pyetjeve, që duhet të mirren parasysh në situata konflikti.

#### Mirëpo në parim refuzohet:

- Zgjidhja diktatoriale e realizuar me ngulm
- „Shtypja“ e mendimeve të ndryshme

*Si mësimdhënës, duhet të keni parasysh se nxënësit në parim, nuk refuzojnë secilën masë edukative që vjen nga të rriturit. Anketat e bëra na bëjnë me dije se shumica e të rinjëve u japin të drejtë të rriturve, vetëm nëse këta (të rriturit) janë në gjendje ti arsyetojnë mirë masat dhe udhëzimet e tyre. Qëllimi duhet të jetë një zgjidhje konstruktive.*

## Hapat për zgjidhjen e konflikteve

### Analiza e gjendjes

- A ka prani të interesave të kundërta?
- Kush është i kyçur në konflikt?
- Mënyra e argumentimit?
- Çka mund të nxjerrim nga konflikti?
- Çfarë natyre ka konflikti?

### Vlerësimi i informatave

- Çka është thelbësore?
- Çka është e vërtetë?
- Çka është e zgjidhshme?
- Çfarë qëllimi fshihet pas tërë kësaj?
- Cilët individ, në cilën anë gjinden?
- Cilat informata na mungojnë?
- Cilat janë shkaqet?

### Zgjidhjet ideore të konfliktit

- Cila është zgjidhja thelbësore e cila momentale?
- Cilat pasoja të mundshme mund rezultojnë nga zgjidhja e paraparë e konfliktit?
- Si do të fillohet me zgjidhjen e konfliktit?

### Këshilla për zhvillimin e „bisedës konfliktuoze“

- Keni parasysh se personat në konflikt kanë për ju një motivim me arsye
- Të përcjellat akceptimi i partnerit: edhe emocionet duhet pranuar
- Të mos ngutemi të marrim përsipër udhëheqjen e bisedës
- Gradualisht të mirret udhëheqja / UNË- porosinë: Unë shoh...

## Konfliktet

# 7

### Strategjitë e tejkalimit të konflikteve gjatë shkollimit

Një „bisedë konfliktuozë“ e përgatitur mirë, mund të eliminojë shkaqet e një konflikti. Një bisedë e tillë ndahet në pesë faza tipike:

#### Fazat e „bisedës konfliktuozë“

<b>1</b>	<b>Faza hyrëse</b>	Mundësisht të krijohet një atmosferë mirëbesimi, të qetësohen shpirtërat, dhe të potencohet rëndësia e zgjidhjes së problemit
<b>2</b>	<b>Faza e përshkrimit</b>	Personat pjesëmarrës në konflikt paraqesin pikëpamjet e tyre lidhur me problemin dhe me këtë rast shpesh vjen deri tek eliminimi i ngarkesës prezente emocionale
<b>3</b>	<b>Analiza e shkaqeve</b>	Me kujdes, tentohet të bëhet emërtimi, së bashku me partnerin në konflikt, i shkaqeve të mundshme
<b>4</b>	<b>Kërkimi për zgjidhje</b>	Kërkim i përbashkët për zgjidhje, pasi që janë zbuluar shkaqet, duke u munduar të arrijmë ndryshime në mënyrën e sjelljes
<b>5</b>	<b>Aplikimi dhe kontrollimi</b>	Provohet rruga e zgjedhjes së arritur bashkë dhe kjo kontrollohet pas një kohe dhe eventualisht të ndërmerren ndryshime të bazuara në bisedat e ardhshme



Çdo konflikt mund të zgjidhet. Por kjo nuk do të thotë se çdo konflikt edhe zgjidhet me të vërtetë. Mirëpo ekziston mundësia për një gjë të tillë. Sipas vlerësimeve, pothuajse 70% e të gjitha konflikteve mund të zgjidhen, kur njeriu gjenë një mënyrë më të mirë të komunikimit. Për 20% të konflikteve janë të domosdoshme bisedat ndërsa 10% e tyre zgjidhen përmes ndërhyrjes së një personi të pavarur.



Shpesh u bie vështirë mësimehmënësve të ndërmjetësojnë një pasqyrë të qartë të disponimit të ndonjë grupi, sidomos kur konfliktet rriten:

Dy metoda duhet të ndihmojnë në tejkalimin e gjendjeve të tilla:

### Vështrim i shpejtë i konfliktit

- Secilit nxënës i mundësohet ti tregojë grupit se si ndihet për momentin
- Për këtë, mësimehmënësi duhet të paraqtojë një pyetje konkrete mbi ndjenjat momentale:
  - *Si e ndien vehten për momentin?*
  - *Si ishte puna e përbashkët në grupe?*

- *Secili nxënës ka mundësi për t'u shprehur*
- *Secili thotë aq sa dëshiron, pak apo shumë*
- *Asnjë thënie nuk komentohet apo diskutohet*

Një njoftim i tillë i shpejtë është i mundur në fillim apo në fund të asaj dite të mësimit.


Një metodë tjetër është barometri i disponimit:

### Barometri i disponimit

Në këtë rast, mësimehmënësi i prezanton grupit një pllakat (është e mundur edhe në tabelë).

Secilit nxënës i jepet mundësia për të paraqitur disponimin e tij në një shkallë të paracaktuar.

Në fund do të diskutohet barometri i disponimit!



*Ju luem, keni parasysh edhe mundësinë e lojës së roleve në situata konflikti, të përmendura në paragrafin 5.4.*